



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:083351

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06773651

**P.nr.260/24**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtore profesionale Leonita Lajqi-Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.Z, për shkak të veprës penale “*Rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.159/2024 të datës 21.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me datën 20.01.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të dëmtuarit A.H, të pandehurit A.Z, mbrojtësi i të pandehurit A.Z, av.Taulant Broqi, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 23.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 29.01.2025, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I pandehuri:

**A.Z**, i lindur me datë ..... në ....., në ....., me vendbanim në fshatin ....., ....., rr. “.....”, nr. ..., në Pejë, nga i ati D. dhe e ëma M. e gjinisë ....., i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes se ... ekonomike, ....., me numër personal ....., posedon numër telefonit ....., i nacionalitetit ....., Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

### ËSHTË FAJTOR

#### Për shkak së:

*Me datën 27.12.2023 rreth orës 14:07 minuta, në aksin rrugor Pejë-Mitrovicë, pikërisht në fshatin ..... përball marke “...”, nga pakujdesia shkel nenin 45 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyre që, gjersa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e tipit ....., ngjyrë ....., me targa ....., kur arrin në vendin e lartcekur, nuk e respekton shenjën STOP dhe nuk i jep përparësi mjeteve me përparësi kalimi, me ç ‘rast kyçet në rrugën kryesore, ku e godet motoçikletën të cilën ishte duke e drejtuar i dëmtuari A.H, e si pasoj e goditjes i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore,*

- Me çka ka kryer veprën penale “**Rrezikimi i trafikut publik**” nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 59, 69, 70, dhe nenit 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, si dhe konform dispozitave ligjore të nenit 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

- I.** Me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) viti, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit prej dy (2) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprën tjetër penale.
- II.** Nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi kryen veprën tjetër penale, dënimi i kushtëzuar nga pika I të këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- III.** Obligohet, i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale për shpenzimet e paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** Të akuzuarit në kuptim të nenit 59 par.1 dhe 2 e lidhur me nën par.2.5, i shqiptohet **DËNIM PLOTËSUES:** “*Ndalimi i drejtimit të automjetit*” në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh, i cili do të llogaritet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** I dëmtuari A.H, nga fshati ....., ....., në Pejë, gjatë shqyrtimit shprehimisht ka hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kërkesën pasurore juridike.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 21.03.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.Nr.159/2024, ndaj të pandehurit A.Z, për shkak të veprës penale p “*Rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 20.01.2025, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, i dëmtuari A.H, i pandehuri A.Z, mbrojtësi i të pandehurit A.Z, av.Taulant Broqi me autorizim zëvendësues nga av.Ardit Kurmehaj nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, përkthyesi i gjuhës boshnjake-praktikanti Sahit Kandiq.

Në këtë seancë, gjykata në pajtim me nenin 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin A.Z, për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Para leximit të aktakuzës, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë. Gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur së i pandehuri e ka kuptuar përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të i njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë.

I pandehuri A.Z, i ftuar që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë, ka deklaruar së e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, respektivisht për veprën penale “*Rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPPRK-së.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit A.Z, gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i cila ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Më pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar i dëmtuari A.H, po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare av.Taulant Broqi, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bërë në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës i tij dhe i kërkoj gjykatës që të njëjtit t’i aprovohet.*

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vlerësuar pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të pandehurit, në raport me nenin 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së, vlerësoi dhe gjeti së i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së këtë pranim të fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, dhe pasi që iu janë komunikuar të gjitha të drejtat sipas KPPRK-së, së një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes si dhe në materialet e dorëzuara nga Prokuroria siç janë: *Procesverbali mbi vend shqimin e aksidentit, i dt. 25.01.2024, Raporti i Aksidentit me nr.0293112, i dt.27.12.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin, i dt. 27.12.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin, i dt.27.12.2023, Fletkontrollë Mjekësore, A.Z, e dt.27.12.2023, Flet kontrolle Mjekësore, A.H e dt.27.12.2023, Ekspertiza Mjeko Ligjore, e dt.16.02.2024, Ekspertiza e aksidentit. E dt.20.02.2024,12 (dymbëdhjetë) foto, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarin në procedurë paraprake, i dt.14.03.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurin në procedurë paraprake, i dt.14.03.2024, dhe së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par.6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave rënduese i propozoj gjykatëse që të marrë parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I dëmtuari A.H ka deklaruar se: *nuk kërkoj kërkesë pasurore juridike, i pandehuri me ka kërkuar falje.*

Mbrojtësi i të pandehurit A.Z, av.Taulant Broqi, ka deklaruar se: *pasi që i mbrojturi im e pranon fajësinë me vullnetin e tij të lirë, kërkoj nga gjykata që gjatë matjes se dënimit të marre parasysh si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin e thellë dhe singëritetin që ka bere nga policia gjerë tani.*

I pandehuri A.Z, ka deklaruar se: *i kërkoj falje gjykatës, jam penduar për veprën penale që e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem shumë i kujdesshëm, i kam kërkuar falje të dëmtuarit, të njëjtit jam mundur që ti ndihmoje edhe materialisht.*

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaramet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë si rrethanë posaçërisht lehtësuese faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë që në shqyrtimin fillestar, pastaj si rrethana lehtësuese gjykata gjeti pendimin, shprehjen e keqardhjes, fakti se i njëjti është pensionist shfrytëzues i skemës sociale prej 120 euro, faktin se i demtuari A.H nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike, po ashtu edhe faktin se i njëjti me parë më nuk ka kryer vepra penale, premtimin e tij gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethana rënduese përveç elementeve të figurës së veprës penale gjykata mori për bazë edhe faktin se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më parë dhe atë me Aktgjykimin P.nr.519/2008, i plotfuqishëm me datën 21.08.2008, sipas të cilit është dënuar me dënim me gjobë të kushtëzuar që nuk do të ekzekutohet nëse gjatë periudhës së verifikimit prej 1 viti të mos kryej veprë tjetër penale.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par. 3 të KPPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, mbi këto arsye, gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin me burgim të kushtëzuar si në piken I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, në kuptim të nenit 46, 47, 48, dhe 49 par.1 sipas të cilit *“Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”*, e lidhur me nenin 370 par.1 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale rrezikim i trafiku publik e kryen: *“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”*, ndërsa në par.6 të nenit të lartcekur është paraparë forma e privilegjuar e kësaj vepre penale, ku përcaktuar se *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”* ndërsa në par.8, ku parashihet se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Gjykata thekson se veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është mospërfillja e dispozitave të trafikut, gjë që nënkupton sjellje apo veprime të tilla të pjesëmarrësit në trafik me të cilat ai cenon dispozitat që rregullojnë trafikun rrugor, andaj vepra penale rrezikimit të trafikut publik konsumohet kur për pasojë të veprimit në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, trafiku është rrezikuar duke sjellë në rrezik jetën dhe trupin e njeriut ose pasurinë, e që në rastin konkret i dëmtuari ka marrë lëndime të rënda trupore. Ndërsa, kualifikimi i veprës penale nga paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të nenit 370 të KPRK-së, është bërë duke marrë për bazë situatën kur vepra penale themelore (1 dhe 2) kryhen nga pakujdesia, formë e cilësuar e tyre janë rastet kur nga si pasojë e këtij aksidenti shkaktohet lëndimi i rëndë trupor, e që në rastin konkret si pasojë e aksidentit të ndodhur i dëmtuari A.H ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Në kuptim të nenit 50 të KPRK-së, gjykata do të revokojë dënimin e kushtëzuar nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit. Gjykata ka shqyrtuar propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me shqiptimin e dënimit plotësues *‘Ndalimi i drejtimit të automjetit’* dhe mundësinë e shqiptimit të dënimit plotësues siç parashihet me nenin 64 të KPRK – së, dhe të njëjtin e ka aprovuar duke i’u ndaluar të pandehurit drejtimin e automjetit në kohëzgjatje prej dy (2) viti, i cili dënim plotësues fillon të ekzekutohet pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, kjo pasi që i pandehuri me veprimet e tij ka paraqitur rrezik të lartë tek pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, me çka me veprimet e tij ka shkaktuar lëndime trupore të të dëmtuarit A.H dhe këtu gjykata gjen se është në interes të sigurisë publike që të njëjtit t’ia heq të drejtën për të drejtuar automjetin.

Andaj për këto arsye kjo gjykatë vjen në përfundim se është formuar bindja se ekziston rreziku se i pandehuri sërish mund të kryej vepër penale nga kapitulli XXX të KPRK – së, e kjo duke pasur parasysh edhe moshën e të pandehurit i cili është 79 vjeçar, dhe nga arsyet e lartcekura ka vendosur duke i shqiptuar dënim plotësues nga neni 64 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ekspertizës mjekoligjore, si dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe në mbështetje të nenit 242 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.260/24, me datën 29.01.2025.**

**Bashkëpunëtore profesionale:**

**Gjyqtarja e vetme gjyqesore:**

\_\_\_\_\_  
**Leonita Lajçi Muçaj**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë